

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot me date 09/06/2023 (dymije e njezete e dy), ne Tirane, u perpilua kjo kontrate shitje kuotash nga palet si me poshte vijon:

1. **Z. Ymerli Zaimi** mbajtës i kartës së identitetit me nr I30411061N., i datëlindjes 11/04/1983 dhe banues në Tiranë, qe ketu e me poshte do te quhet ("Shitesi").
2. **Z. Rezart Xhepexhiu** mbajtës i kartës së identitetit me nr J51015093R, i datëlindjes 15/10/1995 dhe banues në Tiranë. qe ketu dhe me poshte do te quhet ("Bleresi")

Shitesi dhe Bleresi jane referuar me poshte individualisht si "**Pala**" dhe se bashku si "**Palet**".

DEKLARATA PARAPRAKE:

Neni 1

Pala shitese eshte ortak me 90% te kapitalit Shoqerise "**MR engineering**" shpk, rrcgjistruar ne QKB me NIPT M31717012I dhe administrator z. **Rezart Xhepexhiu**.

Pala blerese eshte ortak me 10% te kapitalit Shoqerise "**MR engineering**" shpk, rrcgjistruar ne QKB me NIPT M31717012I dhe administrator z. **Rezart Xhepexhiu**.

- 1.1 Me ane te kesaj kontrate Shitesi Ymerli Zaimi i transferon Bleresit Rezart Xhepexhiu me ane te shitblerjes 80 % te kapitalit te zoteruar ne Shoqerine **MR engineering** Sh.p.k
- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë 80% te kapitalit te shoqerise **MR engineering** shpk.
- 1.3 Nepermjet transferimit me ane te shitblerjes, kapitali themeltar i shoqërisë transferohet tek ortakët ne kete menyre:
 - a- Ortaku **Ymerli Zaimi**, eshte zoterues i **10%** të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlere te pergjithshme **10,000** leke.
 - b- Ortaku **Rezart Xhepexhiu**, eshte zoterues i **90%** të kapitalit themeltar të shoqërisë me vlere te pergjithshme **90,000** leke.
- 1.4 Transferimi i kesaj shitblerjeje do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" me ndryshimet perkatese.
Palet bien dakord per nenshkrimin e kesaj kontrate per shitjen e kuotave nepermjet Shitesit dhe Bleresit ("**Kontrata per Shitjen e Kuotave**" ose "**Kontrata**"), si me poshte vijon:



Neni 2

Objekti i Kontrates

- 2.1 Ne daten e nenshkrimit te kesaj Kontrate (“**Data e Nenshkrimit**”), Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi blen nga Shitesi Kuotat ne Shitje te lire nga cdo Barre.
- 2.2 Cmimi i rene total dakort per Kuotat ne Shitje eshte cmimi prej 80,000 leke (tetedhete mije) dhe Cmimi i Blerjes ne total per Kuotat ne Shitje, eshte likujduar teresisht ndermjet paleve.
- 2.3 Kuota ne Shitje do te transferohen juridikisht nga pronesia e Shitesit ne pronesi te Bleresit dhe pala Blerese do te behet zoterues ligjor i gjithe kuotes ne shitje menjehere pas rregjistrimit te kesaj kontrate prane QKB-se.

Neni 3


Deklarimet dhe Garancite e Shitesit

- 3.1 Shitesi deklaron dhe garanton ne lidhje me transakcionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijojne.
 - 3.1.1 *Autorizimi* – Te gjitha veprimet, aktet dhe / ose procedurat e tjera te parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqerise qe duhet te ndermerren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate jane kryer rregullisht. Kjo Kontrate eshte nenshkruar dhe dorezuar rregullisht nga Shitesi dhe perben nje detyrim te vlefshem dhe ekzekutiv per Shitesin dhe qe duhet zbatuar prej tij, ne perputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates.
 - 3.1.2 *Nenshkrimi* – Nenshkrimi i kesaj Kontrate nuk kerkon asnje depozitim, miratim, autorizim te cfaredolloji nga ndonje autoritet shteteror ose pale e trete.
 - 3.1.3 *Pronesia* – Shitesi eshte pronar i vetem dhe i ligjshem i Kuotave ne shitje. Kuota eshte percaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe jane shlyer plotesisht nepermjet kontributit ne para ne kapitalin themeltar te Shoqerise.
 - 3.1.4 *Kuotat* - Kuotat jane te lira dhe te cliruara nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe Shitesi ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'i shitur, per t'i kaluar, transferuar dhe dorezuar Kuotat ne perputhje me afatet e kesaj Kontrate. Nuk ka asnje kontrate, marreveshje ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Kuotat ose ndonje numer Kuotash te autorizuar por te paemtuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Kuotat. Pervec kesaj Kontrate, nuk ka asnje kontrate, marreveshje, ose detyrim qe parashikon dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin ose dhenien e se drejtes nje personi, te drejten e parablerjes apo te kembimit, ne lidhje me Kuotat objekt te kesaj kontrate.

Neni 4

Ligji i zbatueshem dhe juridiksioni kompetent

- 4.1 Kjo Kontrate rregullohet nga ligji Shqiptar.
- 4.2 Cdo konflikt ne lidhje me lidhjen, interpretimin, zbatimin, zgjidhjen, perfundimin e Kontrates do te zgjidhet nga juridiksioni kompetent gjyqesor shqiptar.



Neni 5
Te ndryshme

- 5.1 Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim, me akt noterial dhe nenshkruhet nga ose ne emer te seciles Pale.
- 5.2 Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre dispozitave ose detyrimeve ne nje juridiksion tjetër, nuk do te preket nga nje fakt i tille.
- 5.3 Palet do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masen me te madhe te mundshme, per te arritur qellimin e kesaj dispozite.
- 5.4 Kjo Kontrate nenshkruhet ne 4 (kater) kopje origjinale.
- 5.5 Asnjera Pale nuk mund te kaloje dhe / ose te transferoje te drejtat dhe / ose detyrimet sipas kesaj Kontrate, ne teresi ose ne vecanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Pales tjetër.
- 5.6 Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, secila Pale do te paguaje shpenzimet e saj ne lidhje me negocimin, hartimin, nenshkrimin e kesaj Kontrate dhe shtojcave te saj.

SHITESI

Ymerli Zaimi



BLERESI

Rezart Xhepexhiu

